



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 289, datë 08.09.2020

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E
POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR
POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 91, DATË 26.02.2020, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 08.09.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, si dhe propozimin për përfundimin e kësaj procedure për kandidaten znj. {...},

V Ë R E N

**I. TË DHËNA PËR PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KËRKESËN E
KANDIDATES PËR T’U TËRHEQUR NGA KANDIDIMI**

1. Me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”

2. Me vendimin nr. 89, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

3. Afati i kandidimit është katër javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”

3. Me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

3. Afati i kandidimit është gjashtë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”

4. Me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”

3. Afati i kandidimit është tetë javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”

5. Njoftimi për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë për këto pozicione të lira janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 28.02.2020, duke filluar kështu afati i kandidimit më datë 29.02.2020.

6. Afatet e kandidimit për ngritjen në detyrë, përfshirë edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u pezulluan nga Këshilli më datë 12.03.2020, për shkak të situatës së krijuar në vend nga përhapja e Covid-19, ndërkohë që me Vendimin e tij nr. 142, datë 22.04.2020, këto afate u zgjatën edhe për një periudhë tjetër të caktuar. Konkretisht, për pozicionin e lirë që i korrespondon procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të hapur nga Këshilli me Vendimin e Këshillit nr. 88, datë 26.02.2020, afati i kandidimit u zgjat me një javë, duke përfunduar ai më datë 29.04.2020; për pozicionin e lirë të hapur me Vendimin e Këshillit nr. 89, datë 26.02.2020, afati i kandidimit u

zgjat me tre javë, duke përfunduar ai më datë 06.05.2020; për pozicionin e lirë të hapur me Vendimin e Këshillit nr. 90, datë 26.02.2020, afati i kandidimit u zgjat me tre javë, duke përfunduar ai më datë 13.05.2020; për pozicionin e lirë të hapur me Vendimin e Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, afati i kandidimit u zgjat me katër javë, duke përfunduar ai më datë 20.05.2020.

7. Për të katërt pozicionet e sipërcituara, në kohë të ndryshme, ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

8. Me Vendimin nr. 152, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...

2. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu...”.

9. Në përfundim të afatit të kandidimit, me Vendimin nr. 157, datë 15.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 89, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për shkak se kandidatja nuk kishte aplikuar brenda afatit të kandidimit, Këshilli vendosi mospërfshirjen e saj në listat e kandidatëve për këtë pozicion të lirë. Ndërsa me Vendimin nr. 190, datë 04.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” si dhe Vendimin nr. 191, datë 04.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” mbështetur në pikën 7, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, Këshilli ka vendosur që procedura e verifikimit për kandidaten znj. {...} e filluar me Vendimin e tij nr. 152, datë 06.05.2020, për kandidimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 88, datë 26.02.2020, është e vlefshme edhe në lidhje me kandidimin e saj për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e tij nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020.

10. Më datë 07.05.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

11. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

12. Më datë 12.05.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

13. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019), si dhe pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 88, nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020, relatorja kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatit në lidhje me katër kriteret formale¹ të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicionet e lira të shpallura me këto vendime. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 208, datë 18.06.2020, Këshilli vendosi:

1. *Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*
2. *Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr. 90, datë 26.02.2020.*

¹ Tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

3. *Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.*

14. Aktualisht kandidatja është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së kësaj kandidate në kuadër të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

15. Ndërkohë, Këshilli, në Mbledhjen Plenare të datës 09.07.2020 vendosi hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera edhe për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020. Afati i kandidimit për të treja këto pozicione të lira u përcaktua “*deri në datë 31.07.2020*”.

16. Vendimet e sipërcituara janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit më datë 09.07.2020, përfshirë dhe njoftimin publik për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale. Në këto njoftime publike të interesuarve u është kërkuar të kenë në vëmendje se:

“Në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

- *Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë.*
- *Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.*
- *Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidati duhet të rikonsiderojë kandidimet e tij, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin. Mospërcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë.*
- *Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar/përmbyllur dhe kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira”.*

17. Brenda afatit të kandidimit për këto tre pozicione të lira, më datë 30.07.2020, kandidoi edhe kandidatja znj. {...}.

18. Në rastin e kandidimeve të fundit, pra ato të datës 30.07.2020, ndërsa të gjitha pozicionet e lira për të cilat kishte kandiduar për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të ishin në proces, kandidatja znj. {...} *nuk rikonsideroi kandidimet e saj, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijonte kandidimin, pavarësisht kujtesës në Njoftimin Publik të datës 09.07.2020.*

19. Megjithatë, për të shmangur çdo penalizim të kandidates të ardhur nga paqartësia e asaj çka kërkohet, në respektim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, në Njoftimin Publik të datës 09.07.2020, në lidhje me *rikonsiderimin e kandidimeve, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijonte kandidimin, në rastin e kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces*, më datë 04.08.2020, në rrugë elektronike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ftoi kandidaten të rikonsideronte kandidimet e saj për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të përcaktuar tre pozicionet e lira për të cilat do të vijonte kandidimin.

20. Po në rrugë elektronike, më datë 04.08.2020, **kandidatja znj. {...} është shprehur se:** “... Zgjedh të listoj preferencat e mia si më poshtë:

1-Për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

2-Për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

3-Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë”.

Në këtë mënyrë kjo candidate duke zgjedhur në mënyrë të shprehur tre pozicionet e lira për të cilat do të vijonte kandidimin për ngritje në detyrë, hoqi dorë nga kandidimi i saj për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020.

21. Në rrethanat sa sipër, relatorja ka përgatitur relacionin bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës

të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

22. Në Mbledhjen e datës 02.09.2020, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit paraprak të ndjekur për kandidaten znj. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT PËR T’U TËRHEQUR NGA KANDIDIMI

23. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 136, pika 1 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin).

24. Këshilli në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”.* Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi*

publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

25. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Vendimin 75/2019. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 6, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”.*

26. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja znj. {...}, brenda afatit të kandidimit, ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë, pikërisht të procedurës së verifikimit të kritereve të kandidimit, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim në lidhje me këtë, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritje në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit kërkesë, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t’u tërhequr nga kandidimi.

III. KONKLUZIONE

Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë candidate.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatores së çështjes,

V E N D O S I :

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR